# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5993
E martë, 4 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Analistët kanë pritje modeste nga qeveria e re

FAQE 6




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


REPUBLIKA E KOSOVËS BËHET ME QEVERI TË RE FAQE 4-5

# ERDHI DITA E KURTIT



Me 66 vota Kuvendi i Kosovës ka votuar të hënën për formimin e qeverisë së re të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, e cila doli e para në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit të vitit të kaluar. Kosova u bë me qeveri të re gati katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe votimi i saj erdhi pas negociatave të gjata ndërmjet LV-së dhe LDK-së. Para se të votohej qeveria Kurti, partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë lëshuar sallën. Përfaqësuesit e këtyre partive gjatë seancës për votimin e qeverisë e kanë kritikuar Kurtin për ndryshimin e parimeve të tij gjatë kohës sa ishte në opozitë si dhe e kanë kritikuar programin qeverisës. Qeveria e re e do t'i ketë 15 ministri. Kryeministri i ri do t'i ketë edhe dy zëvendëskryeministra, kurse në përbërjen e saj qeveria pritet t'i ketë edhe 33 zëvendësministra

## NË KOSOVË NUK ËSHTË REGJISTRUAR ASNJË RAST NGA KORONAVIRUSI I RI

Të hënën është mbajtur mbledhja e dytë e Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ku është konstatuar se janë përforcuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së koronavirusit të ri. Në këtë mbledhje është konfirmuar se në Kosovë nuk ka të regjistruar asnjë rast nga koronavirusi i ri FAQE 7



## OPINION

### STRUKTURA E ATOMIT NDRYSHON TËRËSISHT NGA AJO QË NJEH FIZIKA E TANISHME F. 11

Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan



## AKTUALE



### SASSOLI: SHQIPTARËT E MERITOJNË MBËSHTETJEN PËR INTEGRIM NË BE F. 2

### SA U RREZIKOHET SHËNDETI MJEKËVE GJATË PUNËS? F. 3

## EKONOMI

### KOSOVA KA MBI DY MILIONË PËRDORUES TË TELEFONISË MOBILE F. 9

### TELEKOMI I KOSOVËS, MES PRIVATIZIMIT DHE FALIMENTIMIT F. 9



## SPORT

### ELSHANI: GJILANI KUNDËRSHTAR I FORTË, POR KEMI AMBICIE PËR KUPË F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kim: Jam e prekur nga mikpritja shqiptare



Tiranë, 3 shkurt - Ambasadorja e ShBA-së, në Tiranë, Yuri Kim, pas serisë së takimeve që ka zhvilluar që nga presidenti i vendit, kryeministri dhe ministrat e kabinetit e të tjerë përfaqësues të lartë të politikës në Shqipëri, nuk e ka fshehur se është e prekur nga mikpritja që i është rezervuar.
Ambasada amerikane në një shënim në Facebook, teksa ka postuar një foto, ku ambasadorja Kim ka pozuar në mes të presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta dhe kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi.
Në postimin në Facebook, ambasadorja Kim shprehet se mikpritja shqiptare është fakt. "Jam e prekur nga pritja e ngrohtë që kam marrë në Shqipëri. Tani e kuptoj që legjenda për mikpritjen shqiptare është thjesht pohim i një fakti", u tha ambasadorja e Shteteve të Bashkuara Yuri Kim të ftuarve në pritjen që ajo organizoi në 30 janar për përfaqësues të komuniteteve politike, diplomatike, të biznesit, shoqërisë civile, medias, kulturës dhe bashkësive fetare.

# Sassoli: Shqiptarët e meritojnë mbështetjen për integrimin në BE

**Presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, në një konferencë të përbashkët shtypi me kryeministrin Edi Rama deklaroi se shqiptarët duhen mbështetur në rrugën drejt BE-së dhe meritojnë përgëzime për hapat, që kanë ndërmarrë dhe besimin e madh që kanë te BE-ja**



TIRANË, 3 SHKURT - Presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, deklaroi në Tiranë se shqiptarët duhen mbështetur në rrugën drejt BE-së dhe meritojnë përgëzime për hapat, që kanë ndërmarrë dhe besimin e madh që kanë të BE-ja.
Sassoli i bëri këto komente në një konferencë të përbashkët shtypi me kryeministrin Edi Rama në Shqipëri, ku deklaroi se kur BE-ja i tha "Jo" Tiranës për hapjen e negociatave pati shumë zhgënjim.
Megjithatë shtoi se pavarësisht zhgënjimit, të gjithë duhet të punojnë për të vijuar rrugën drejt integrimit të vendit në BE.
"Ndodhi një ngadalësim në fundit të vitit, por procesi i anëtarësimit duhet të fillojë, dhe për këtë janë të bindur Parlamenti dhe Komisioni Evropian", tha Sassoli.
Ai tha se lufta ndaj krimit, bllokimi i pasurive të krimit janë nisma të domosdoshme. Dialogu është rifilluar brenda afateve të shkurtra dhe të gjithë jemi dëshmitarë për zhgënjimin që pati shoqëria shqiptare ashtu si edhe ne, por kjo duhet ta kapërcejmë këtë, tha ai.
"Duhen të binden të gjithë se rruga e integrimit duhet bërë patjetër së bashku, sepse kemi një fat të përbashkët dhe duhet të përshtatemi", tha Sassoli, ka njoftuar voa.
Ai theksoi se BE-ja tregoi gatishmëri për të ndihmuar Shqipërinë dhe me ndihmat për rindërtimin pas tërmetit dhe për të ardhmen. Ai tha se Shqipëria është një vend i rëndësishëm i Ballkanit Perëndimor.
"Dy janë sfidat e përbashkëta: Evropa ka një synim ambicioz - procesin e anëtarësimit, dhe së dyti është tema e solidaritetit dhe sigurisë. Për të dyja këto fusha do të punohet shumë, sepse janë shoqëritë që po u kërkojnë institucioneve nisma dhe përkushtim", tha Sassoli.
Ndërsa kryeministri Edi Rama tha në konferencën e shtypit se diskutoi me Sassoli procesin e integrimit, datat e reja, si dhe për ligjin Anti-KÇK.
"Vizita e presidentit Sassoli sot përkoi me operacionin e parë në terren të forcës së ligjit, që besoj shumë do të përçojë një mesazh të qartë me fakte e jo me fjalë mbi sa seriozë e të vendosur jemi për të ndryshuar rrënjësisht këtë vend", tha Rama.
Sassoli mbajti një fjalim në Parlamentin shqiptar, ku bëri thirrje të vazhdojë me këmbëngulje puna për integrimin evropian dhe zhvillimin e vendit.
Presidenti i Parlamentit David Sassoli nisi të hënën një vizitë dy ditore në Shqipëri, për të dhënë një sinjal mbështetje ndaj vendit në rrugën e tij të integrimit evropian, siç u shpreh ai në një mesazh video në Tëitter.
"Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian dhe shumica e vendeve anëtare janë në favor të hapjes së bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Nuk do të dorëzohemi. Ne do të vazhdojmë të shtyjmë për një votë pozitive", deklaroi ai përmes mesazhit përpara nisjes së vizitës.
Ai pati dhe një thirrje drejtuar të rinjve shqiptarë. "Mos humbisni shpresën. Ne duam që ju të bëheni pjesë e Bashkimit Evropian. Së bashku mund ta bëjmë këtë realitet. Duhet të jemi shpresëplotë dhe të vazhdojmë përgjatë rrugës që keni nisur", tha Sassoli.

## Osmani: Shtyrja e zgjedhjeve vetëm me konsensus të ri të liderëve



SHKUP, 3 SHKURT,- Lideri i LSDM-së Zoran Zaev, të hënën pas dëshmisë të dhënë në Gjykatë për rastin "Monstra", është deklaruar edhe për Ligjin për Prokurori Publike.
Siç ka potencuar Zaev, nëse opozita tenton të bllokojë në Kuvend këtë ligj, atëherë do të shtyhet shpallja e zgjedhjeve dhe shpërbërja e Parlamentit, por jo dhe zgjedhjet të cilat është paraparë të mbahen më 12 prill.
"Për mua është shumë me rëndësi të votohet ligji në Parlament dhe më pas të shihet nëse do të sillet apo jo. Ndërsa më 12 shkurt Kuvendi duhet të shpërbëhet. Por, nëse opozita tenton të minojë apo të bllokojë votimin, atëherë normalisht se Parlamenti nuk do të shpërbëhet derisa të përfundojë procesi i sqarimit dhe për Ligjin për Prokurori Publike dhe për Protokollin për NATO, apo për Ligjin për mbrojtje dhe ligjeve të ngjashme", ka deklaruar Zaevi.
Ndërsa zëvendëskryeministri i qeverisë, Bujar Osmani në një prononcim për Agjencinë Zhurnal, tha se vendimi për zgjedhjet e parakohshme që duhet të mbahen me 12 prill të këtij viti, është marrë nga gjithë liderët e partive në takim te presidenti i Shtetit, Pendarovski dhe se në rast të ndryshimit të këtij konsensusi, sërish duhet të mblidhen liderët politikë për t'u arritur një konsensus i ri.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Analistët kanë pritje modeste nga qeveria e re

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se pritjet nga qeveria e re duhet të jenë modeste. Ata kanë deklaruar se me këtë qeveri është materializuar vullneti i qytetarëve të Kosovës në zgjedhjet e 6 tetorit. Sipas tyre, qeveria e re duhet ta ndalë të keqen dhe duhet të ndërmarrë veprime konkrete që hapin perspektivën e zhvillimit në vend



EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 3 shkurt** - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur pritje të ndryshme nga qeveria Kurti. Ata kanë thënë se me koalicionin LV - LDK është materializuar vullneti qytetar i shprehur në zgjedhjet e 6 tetorit. Analisti politik Astrit Gashi ka vlerësuar se nga qeveria e re nuk duhet të presim shumë. "Kosova ka qeverinë që e kërkoi. U bë ajo që u dashtë të bëhej, pa vonesat e panevojshme. Vullneti i qytetarëve u zbardhë në letër të marrëveshjes. Zgjedhjet ishin për qeverinë e re, jo për kryesinë e Kuvendit. Qytetarët zgjodhën Albin Kurtin për kryeministër në koalicionin me LDK-në. Nga nesër ai edhe do të jetë. Vullneti i votuesit u plotësua", ka thënë Gashi. Sipas tij, kjo qeveri e ka detyrë ta ndalë të keqen në vend. "Nga nesër nuk presim shumë. Pritjet janë modeste: ndalim i të keqes dha veprime konkrete që hapin perspektivën e zhvillimit. Një qeverisje e mirë qe e presim, i bënë të parëndësishme dhe të harrueshme vonesat dhe gjithçka që la shije të hidhur këto javë. Për një qeverisje të gabueshme nuk dua të mendoj në këtë çast", ka deklaruar Gashi.

Ndërkaq analisti tjetër politik Bedri Islami ka paralajmëruar një bashkëpunim të vështirë në mes të LV-së dhe LDK-së. "Bashkimi mes LV-së dhe LDK-së do të jetë i vështirë dhe i mundimshëm. Ëndërrimtarët e LV-së nuk mund të jenë në një kohë të gjatë dhe të suksesshme me pragmatikët e LDK-së, kur kjo e fundit ka një fillesë krejt ndryshe politike nga ajo e LV-së. Kam besuar se Albin Kurti do të dalë nga stanjacioni, jo përmes një loje të lexuar dhe të pabukur politike por, si kam pritur, përmes arsyes së duhur, qëndrimit të fortë dhe mendimit racional. LDK-ja, por edhe ai vetë, e futën në një lojë, me dhimbje e them këtë, që nuk është e denjë për figurën e tij, sidomos për figurën e pritur", ka thënë Islami për gazetën "Epoka e re".

E analisti Blerim Vela ka thënë se koalicioni LV - LDK duhet ta ndryshojë mentalitetin qeverisës. "Fëmija i lindur më 9 janar 2008 deri sot ka njohur vetëm keqqeverisjen e PDK-së. Ai/ajo është trajtuar në spitale publike që kanë mungesë të barnave dhe të mjeteve dhe është shkolluar në shkolla publike që nuk prodhojnë dituri të krahasueshme me moshatarët e tij/saj në Evropë. Pas gjashtë vjetëve ky fëmijë do ta fitojë të drejtën e votës. Do të mund të japë verdiktin e tij/saj për të ardhmen. Ai/ajo mund të ballafaqohet me dilemën se a të rrijë në Kosovë apo të emigrojë në Evropë. Kjo është sfida e qeverisë së re LV-LDK që brenda gjashtë vjetësh ta ndryshojë modelin qeverisës në mënyrë që gjithsecili të ketë shanse të barabarta për jetesë të dinjitetshme në vend", ka shkruar Vela në profilin e tij në "Facebook".

# Sa u rrezikohet shëndeti mjekëve gjatë punës?



**Prishtinë, 3 shkurt** - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në të cilën funksionojnë gjithsej 37 klinika, institute dhe shërbime, nuk është bërë asnjëherë vlerësimi real mbi rrezikshmërinë në punë, thonë përgjegjësit në Sektorin për Mbrojtje dhe Siguri në Punë.

Sali Bllaca, shef i sektorit për mbrojtje dhe siguri në punë, në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ndonëse ka klinika brenda këtij institucioni që punojnë me orare të ndryshme, në asnjë klinikë asnjëherë nuk është bërë vlerësimi real mbi rrezikshmërinë e punës.

Varësisht rrezikshmërisë, përcaktohet edhe orari i punës. Kështu që disa prej klinikave punojnë me nga 30 dhe jo 40 orë pune në javë, si dhe kanë pushim të zgjatur vjetor prej 30 ditësh në vend të 20.

Aktualisht klinikat që punojnë me orar të shkurtuar, që konsiderohen edhe me rrezikshmëri më të lartë, janë ajo e Onkologjisë, Radiologjisë, Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv, Klinika Infektive, Kirurgjia, Njësia Nukleare dhe Patologjia.

Sali Bllaca shton se brenda vitit 2020 do të bëhet vlerësimi real i klinikave nga persona përgjegjës, por edhe nga ekspertë të jashtëm. "Atyre klinikave që u është shkurtuar orari i punës, sipas kontratës kolektive, i kanë përcaktuar vetë oraret, pa një matje reale. Shërbimet e tjera nuk përfshihen këtu, por këtë nuk mund ta përcaktojë askush e as ne si institucion, pa e bërë një vlerësim të rrezikshmërisë. Andaj, ne kemi filluar ta bëjmë këtë vlerësim dhe është në përfundim të mjekësisë nukleare. Tash jem në procedura të kontraktimit të shërbimit nga institucione përkatëse dhe ekspertë të jashtëm. Do të thotë, në bazë të kontratës kolektive sektoriale këto shërbime janë përfshirë, por të gjitha do të rivlerësohen, pasi janë masë e përkohshme dhe më pas do të kategorizohen vendet e punës sipas rrezikshmërisë", ka thënë Bllaca.

Në anën tjetër kryetari i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Blerim Syla, bëri të ditur se duke u bazuar në ligjet e Kosovës, domosdo është e përcaktuar edhe rrezikshmëria në vendin e punës. Por, ai shton se sektori për mbrojtje dhe siguri në punë nuk është duke e kryer punën ashtu si duhet dhe disa klinika e gëzojnë këtë të drejtë, derisa të tjera jo. "Ekziston një sektor për siguri dhe mbrojtje në punë, e që nuk është duke e bërë punën të cilën e ka për obligim. Secili profesion i ka specifikat e veta dhe, bazuar në këtë, kemi nxjerrë kontratën kolektive sektoriale ku janë të përcaktuara grupet të cilat i nënshtrohen rrezikshmërisë në punë. Pra, kemi problem në implementimin e ligjit për shkak të neglizhencës, derisa ne, si sindikatë, do t'i ndërmarrim hapat juridikë dhe menaxherët e klinikave që nuk e respektojnë këtë, do të paraqiten në bazë të akteve juridike. Realisht, në shëndetësi janë të rrezikuar qoftë nga kontaminimet fizike deri tek ato psikike, por për fat të keq kontrata kolektive nuk zbatohet si duhet dhe, si të tillë, punëtorët shëndetësorë nuk i gëzojnë përfitimet sa i përket rrezikshmërisë në punë", ka thënë Syla.

Ndërkaq drejtori i Klinikës së Anesteziologjisë dhe Reanimimit, Nehat Baftiu, thotë se në klinikën ku ai punon, kryesisht në sallat e operacionit, të gjitha barnat që përdoren aty për pacientë, lirojnë gazra, të cilat, sipas tij, i thithin mjekët përmes ambientit, derisa shton se ato gazra të liruara i dëmtojnë të gjitha organet vitale, marrë parasysh se anesteziologët marrin pjesë në tri-katër operacione në ditë.

Republika e Kosovës bëhet me qeveri të re

# ERDHI DITA E

Me 66 vota Kuvendi i Kosovës ka votuar të hënën për formimin e qeverisë së re të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, e cila doli e para në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit të vitit të kaluar. Kosova u bë me qeveri të re gati katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe votimi i saj erdhi pas negociatave të gjata ndërmjet LV-së dhe LDK-së. Para se të votohej qeveria Kurti, partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë lëshuar sallën. Përfaqësuesit e këtyre partive gjatë seancës për votimin e qeverisë e kanë kritikuar Kurtin për ndryshimin e parimeve të tij gjatë kohës sa ishte në opozitë si dhe e kanë kritikuar programin qeverisës. Qeveria e re e do t'i ketë 15 ministri. Kryeministri i ri do t'i ketë edhe dy zëvendëskryeministra, kurse në përbërjen e saj qeveria pritet t'i ketë edhe 33 zëvendësministra



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 3 shkurt** - Me 66 vota për, 10 abstenime dhe asnjë kundër, Kuvendi i Kosovës ka votuar të hënën për formimin e qeverisë së re të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti.

Para se të votohej qeveria Kurti, partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë lëshuar sallën. Ndërkaq dy deputetët e AKR-së, Behgjet Pacolli dhe Mirlinda Sopi-Krasniqi, kanë votuar për formimin e qeverisë.

Qeveria e re është rezultat i koalicionit ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Menjëherë pas zgjedhjes në krye të qeverisë, Albin Kurti është betuar dhe më pas ka mbajtur një fjalim para deputetëve. Kurti ka thënë se nga sot fillon një kapitull i ri për Kosovën. "Me krijimin e qeverisë po jetësojmë edhe vullnetin e qytetarëve që e dhanë në zgjedhjet e 6 tetorit. Sot nuk ka fituar Lëvizja Vetëvendosje e Lidhja Demokratike e Kosovës. Sot kanë fituar qytetarët e Kosovës. Unë zotohem se do të angazhohem maksimalisht për të mirën e të gjithë qytetarëve. Sot fillon rruga jonë e punës së madhe dhe të palodhshme. Sot mbaron rruga e vjetër e klientelizmit dhe e pabarazisë. Nga sot ka një lidership të ri që do të kujdeset për shtetin. Sot fillon edhe një kapitull i ri për politikën e jashtme", ka thënë Kurti pas zgjedhjes kryeministër.

### Kurti: Buxheti do të arrijë në tre miliardë euro

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, para se të votohet qeveria, i ka dhënë fjalën mandatarit për kryeministër, Albin Kurti, i cili në elaborimin e programit qeverisës ka thënë se qeveria e tij do të jetë një "qeveri e kursimit të parasë publike". Kursimet, tha ai, kanë nisur me reduktimin e ministrive nga 21 sa ishin në qeverinë paraprake, në 15. Kurse nga 80 poste të zëvendësministrave, ai tha se qeveria e tij do të ketë rreth 33 sosh. Po ashtu, Kurti ka theksuar se kursimet do t'i përfshijnë të gjitha fushat, duke nxitur zhvillimin ekonomik, shtimin e vendeve të reja të punës dhe ndaljen e emigrimit të qytetarëve të Kosovës për në vendet e tjera evropiane. "Në Kosovë sot ka më shumë treg të zi e të hirtë sesa treg të lirë. Ne këtë do ta ndryshojmë", është shprehur Kurti. Ai ka pohuar se Administrata Tatimore dhe Dogana do të bashkohen për ta lehtësuar mbledhjen e tatimeve.

Kurti ka premtuar se buxheti do të arrijë në 3 miliardë euro. Kurse sa i përket tregut të punës, ka premtuar mbrojtje të punëtorëve, duke synuar që punonjësit të punojnë nga 8 orë në ditë apo 40 orë në javë. Për t'i respektuar këto kritere, Kurti ka thënë se do ta rrisë numrin e inspektorëve të punës që do ta garantojnë zbatimin e ligjit.

Kurti ka shtuar se do të angazhohet që qeveria nën drejtimin e tij ta luftojë korrupsionin, të nisë procesin e vettingut të përgjithshëm si dhe është zotuar që shërbimi ushtarak në Kosovë të jetë i detyrueshëm, për një kohëzgjatje prej tre muajve. Nga aspekti politik, Kurti ka deklaruar se është i gatshëm t'i udhëheqë bisedimet me Serbinë, duke krijuar një ekip gjithëpërfshirës.

Ndërkaq shefat e Grupeve Parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë theksuar se programi qeverisës i këtij koalicioni është i koordinuar nga dy partitë që, sipas tyre, prek të gjitha fushat. "Kjo seancë është ngjarje historike, në Kosovën e pas pavarësisë, sepse për herë të parë opozita ka fituar. Sot kemi për ta votuar Qeverinë Kurti dhe koalicionin që aq shumë e pritën qytetarët tanë", ka thënë shefja e grupit parlamentar e LV-së, Fatmire Mullhaxha-Kollqaku.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se për programin qeverisës janë marrë vesh dy partitë. "Sot kemi një program qeveritar të koordinuar i cili i ka të gjitha fushat e mbuluara. Ky program, i hartuar nga LV-ja dhe LDK-ja, është bërë me marrëveshje. Sot jemi para jush me një program të koordinuar dhe me një listë për ministra shumë të mirë dhe jemi para jush ta kërkojmë besimin tuaj për qeverinë e re", ka thënë Gashi.

### Opozita kritikon Kurtin

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në fjalën e tij para deputetëve

# KURTIT



në seancën për zgjedhjen e qeverisë, ka thënë se sot po synon të bëhet kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, i cili as nuk e njeh e as nuk e ndien Republikën e Kosovës si shtet prandaj, sipas tij, Kurti nuk mendon as të jetojë në Kosovë. Veseli ka renditur disa të vërteta që, sipas tij, duhet t'i dinë qytetarët në këtë ditë. "E vërteta e parë është se si po ua lëmë Kosovën sot, të cilën ti Albin Kurti as nuk e njeh, as nuk e ndien dhe as nuk e mendon si vend për të jetuar. E vërteta e dytë, fatkeqësisht, tregon se ti je sot mbi rrënojat e një tregimi të zi për shtetin dhe shtetësinë e Kosovës. Ti ke protestuar kundër gjithçkaje të mirë që i ka ndodhur Kosovës. Ke sulmuar policët më të mirë dhe institucionet e Kosovës", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së i shtroi pyetje Albin Kurtit, duke e pyetur se a do ta luftojë Serbinë me këtë qeveri, apo ushtarët e UÇK-së përmes Gjykatës Speciale? "Sepse ti dhe gjysma e ministrave të tu gjithmonë keni kërkuar burg për çlirimtarët e Kosovës. Si është e mundur që asnjë patrioti nuk i bëre vend në kabinetin qeverisës? I eliminove edhe në Kuvend", ka thënë Veseli.

Kreu i PDK-së ka paralajmëruar nismat kryesore që do t'i iniciojë PDK-ja në Kuvend. "Partia Demokratike e Kosovës do të kërkojë përgjegjësi për temat më të ndjeshme të Kosovës që nga paslufta. Do t'i hapim dhe diskutojmë këtu krejt marrëveshjet e arritura në dialog, për ta mësuar të vërtetën a ka tradhti a jo? Nëse ti shkon në dialog pa kërkuar falje Serbia, pa u kthyer eshtrat e secilit shqiptar, siç ke premtuar, a je tradhtar a jo? Do të flasim për taksën e vendosur ndaj Serbisë. A do ta heqësh ti apo jo? Do të flasim për të gjitha pasurimet në Kosovë, privatizimet dhe tenderimet. Do të flasim për krimet e komunistëve jugosllavë mbi shqiptarët në Kosovë. Do të flasim edhe për vrasjen e Astrit Deharit, me emrin e të cilit keni abuzuar dhe akuzuar çdo kundërshtar politik, përfshirë këta që i keni në koalicion. Do të flasim edhe për UÇK-në, edhe për ShIK-un. Do të flasim për sulmet terroriste të 'Syrit të Popullit', mbi individë, familje dhe institucione. Do të flasim për të gjitha që duhet e, mbi të gjitha, edhe për vrasjet politike me të cilat shpesh është abuzuar me tragjeditë e tyre në kohë fushatash", është shprehur Veseli. Kryetari i PDK-së ka thënë se koalicioni LV-LDK do të jetë koalicion i pazareve dhe nuk do të marrë asnjë vendim të mirë për Kosovën. Ai ka thënë se PDK-ja do të jetë gjithmonë në mbrojtje të vendit dhe qytetarëve.

Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Teuta Haxhiu, shprehi kritika ndaj Albin Kurtit, i cili, sipas saj, "duke gëlltitur fjalët dhe premtimet, tashmë synon kreun e ekzekutivit". "Ne e dimë që jeni mashtrues, por çdo ditë do ta kuptojnë edhe qytetarët", ka thënë ajo. Haxhiu ka thënë se qeveria e udhëhequr nga Kurti do ta ketë jetën e shkurtër. Ajo e ka quajtur Albin Kurtin monark, me sjellje arrogante. "Albin Kurti e bëri kurban Glauk Konjufcën vetëm për të ardhur në pushtet, njëjtë siç e bëri Isa Mustafa me Vjosa Osmanin", është shprehur ajo.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh deputet, Fatmir Limaj, në fjalën e tij në seancën e Kuvendit i ka sugjeruar Albin Kurtit që ta ulë kokën dhe të sillet si kryeministër. "Sugjerimi është që ta ulësh pak kokën dhe sillu si kryeministër i Kosovës. Ule kokën dhe nisja e puno dhe ndërroje traken e opozitarizmit", ka thënë Limaj. Ai ka shtuar se mandatari në të kaluarën nuk e ka kursyer gjuhen e urrejtjes. "Duhet të jesh i kujdesshëm për veprimet që i bënë sepse ato nuk harrohen. Albini ka shumë punë për të përmirësuar për të ndryshuar nga Albini i opozitës. Historia nuk fillon me ju dhe as me ne. Kosova ka histori shumë të gjatë para nesh. Do të përshëndes çdo të mirë që bën kryeministri i vendit tim, sepse çdo punë e mirë i shërben Kosovës", ka deklaruar Limaj. Ai ka thënë se Kurti nuk është ngritur asnjëherë para flamurit të Kosovës. "Ky nuk e di se Kosova ka shtet. Nuk bëhet shteti me fjalime e me filma. Ule kokën dhe mëso se si funksionon shteti", ka thënë Limaj.

Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë se partia e tij do të jetë konstruktive në këtë legjislaturë dhe se do të jenë të pranishëm për të votuar gjithçka që është në të mirë të Kosovës. Ai ka konfirmuar se do ta votojë Kurtin për kryeministër. "Unë dhe njerëzit e mi asnjëherë nuk do ta lëshojmë sallën. Sa herë që votohet diçka e rëndësishme do të jemi këtu. Unë do t'ju votoj juve. Të shohim nga ardhmja, mos të kthehemi në të shkuarën. Jam dhe do të mbetem pjesë e opozitës. Çdo pikë e programit tuaj do të analizohet nga unë, do t'ju dal përballë dështimeve tuaja nëse ato janë të arsyeshme. Kam qenë dhe do të mbetem konstruktiv dhe derisa të kryhet shtetndërtimi i Kosovës do të mbetem ashtu. Puna e mbarë ju qoftë!", ka thënë Pacolli.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 6 tetor 2019. Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më së shumti vota, e përcjellë nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Këto zgjedhje pasuan pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës, pasi që ai kishte marrë ftesë për intervistë në cilësinë e të dyshuarit nga Gjykata Speciale me seli në Hagë.

## Kabineti qeveritar i Kurtit

**Qeveria e re e Kosovës do t'i ketë 15 ministri. Kryeministri i ri do t'i ketë edhe dy zëvendëskryeministra, kurse në përbërjen e saj qeveria pritet të ketë edhe 33 zëvendësministra.**

**Kryeministër i Kosovës, Albin Kurti (LV)**
**Zëvendëskryeministër i parë, Avdullah Hoti (LDK)**
**Zëvendëskryeministër i dytë, Haki Abazi (LV)**
**Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporë, Glauk Konjufca (LV)**
**Ministër i Integrimit Evropian, Blerim Reka (LV)**
**Ministre e Drejtësisë, Albulena Haxhiu (LV)**
**Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami (LDK)**
**Ministër i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi (LV)**
**Ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu (LDK)**
**Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Rozeta Hajdari (LV)**
**Ministër i Mbrojtjes, Anton Çuni (LDK)**
**Ministër i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku (LDK)**
**Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa (LDK)**
**Ministër i Shëndetësisë, Arben Vitia (LV)**
**Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi (LDK)**
**Ministre e Administrimit të Pushteti Lokal, Emilia Rexhepi (Grupi 6+)**
**Ministër për Komunitete dhe Kthim, Dalibor Jevtiq (Lista Serbe)**
**Ministër për Zhvillim Rajonal, Ivan Millojeviq (Lista Serbe)**

## Ganimete Musliu ia vendos Kurtit broshin me flamurin e Kosovës dhe Shqipërisë

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, derisa kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ishte duke prezantuar programin qeverisës, i ka vendosur atij në setër broshin me flamurin e Kosovës dhe Shqipërisë. Këtë veprim Musliu e ka bërë për t'ia kujtuar Kurtit se në të kaluarën çdoherë e ka bartur në setër broshin me flamurin e Shqipërisë.

# GLPS-ja reagon ndaj ndërhyrjeve të fundit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Qendresa RAMA

**Prishtinë, 3 shkurt** - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka shprehur shqetësimin e thellë lidhur me veprimet dhe praktikat e vendosura nga qeveria e fundit në raport me fushëveprimin e pavarur të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). "Që me marrjen e mandatit qeveria Haradinaj ka bërë një sërë shkeljesh ligjore ndaj pavarësisë dhe integritetit të institucionit të AKA-së. Këto veprime kanë rezultuar të jenë tejet të dëmshme dhe shumë të kushtueshme për sistemin e arsimit të lartë në vend, me theks të veçantë për njohjen dhe pranimin e diplomave të studentëve kosovarë nga rrjetet evropiane të cilësisë si ENQA dhe EQAR kjo ngaqë, si rezultat i ndërhyrjeve të shumta e të vazhdueshme të Qeverisë Haradinaj në këtë institucion, Kosova tashmë nuk është pjesë e dy prej rrjeteve më të rëndësishme evropiane të cilat mëtojnë cilësi në arsimin e lartë", është thënë në komunikatën e GLPS-së.




Sipas Grupit për Studime Juridike dhe Politike, veprimi i fundit i Qeverisë Haradinaj dëshmon mungesë të gatishmërisë për përmirësim dhe cilësohet të jetë tejet negativ për krijimin e praktikave shtetërore në raport me institucionet e pavarura sikurse është AKA-ja. "Praktika e vendosur nga kjo qeveri rrezikon t'i normalizojë ndërhyrjet politike të cilat qeveria në ardhje dhe çdo qeveri tjetër duhet t'i kundërshtojë ngaqë në rastin konkret ndërhyrjet politike në këtë institucion kanë dëmtuar rëndë këtë agjenci, së pari duke ia dëmtuar reputacionin, pastaj duke e përjashtuar dhe, së fundmi, duke ia vështirësuar rianëtarësimin e saj në rrjetet evropiane të lartpërmendura. Zhvillimet trevjeçare në institucionin e AKA-së bëjnë thirrje për trajtim të kujdesshëm dhe të veçantë nga qeveria e re. Adresimi i pasojave të shkaktuara nga veprimet e ndërmarra nga qeveria Haradinaj duhet të jetë një nga prioritetet e kësaj qeverie, me qëllim të rianëtarësimit sa më të shpejtë të këtij institucioni në ENQA dhe EQAR, që do ta siguronte cilësinë e kërkuar në sistemin e arsimit të lartë dhe garantimin e pavarësisë së cenuar të këtij institucioni. Prandaj, GLPS i bën thirrje Qeverisë së re që të distancohet nga çfarëdo lloj praktike e ngjashme e cila është në kundërshtim me mandatin e agjencive të pavarura", është theksuar në komunikatën e GLPS-së.

# Shpërblehen me libra nxënësit në Prishtinë

Qendresa RAMA

**Prishtinë, 3 shkurt** - Për 266 nxënës në Komunën e Prishtinës të hënën Rexhep Hoti, koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, ka bërë shpërndarjen e librave si fitues të nivelit komunal të Garës Nacionale në Dituri dhe Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik. Me këtë rast koordinatori Hoti ka theksuar se këto rezultate pozitive janë arritur falë punës së mësimdhënësve, prindërve, por edhe fëmijëve.

Duke theksuar rezultatet e jashtëzakonshme të garave nga të cilat 44,723 nxënës fitues morën shpërblime, mbi 200 drejtorë, prind, staf organizativë u shpërblyen, koordinatori Hoti tha se ka qenë një angazhim vullnetar në gjithë Kosovën në të mirë të arsimit. "Ne sot kemi sjellë para jush libra falë punës suaj. Ju keni dëgjuar se kemi shumë probleme në arsim, por arsimi për ne ka qenë shtylla kryesore. Pa arsimin sot asgjë nuk mund të ecë përpara, prandaj ju jeni e ardhmja. Kjo është çështje fundamentale ku të gjithë ne, prindër, politikanë, shërbyes civilë, mësimdhënës e të tjerë, duhet të jemi në shërbim të arsimit sepse përmes jush ne kemi një shans të jashtëzakonshëm. Përmes arsimit ju do të mund ta formësoni personalitetin tuaj dhe në të ardhmen do të merrni vendime të mëdha për vete dhe për vendin. Kur mendoni ndonjëherë se keni shumë halle e derte si nxënës dhe që keni shumë mangësi për t'i arritur ato që dëshironi në jetë, mos harroni merrni libra dhe lexoni sepse përmes leximit ju mund t'i arrini të gjitha", ka pohuar Hoti.

Edhe drejtori i shkollës "Qamil Batalli", Liridon Maliqi, gjatë ceremonisë ka falënderuar koordinatorin Hotin, stafin e shkollës, por edhe prindërit për arritjen e rezultateve në gara. "Ne si shkollë kemi bashkëpunuar me koordinatorin Hoti dhe ekipin e tij, por kjo është dita më e mirë për neve sepse kemi pasur sfida me javë të tëra. Ne kemi qenë pjesëmarrës në këtë garë me nxënësit e shkollës sonë, të cilat kanë qenë interesante dhe e rëndësishmja është që fëmijët janë ndarë të kënaqur. Pas pak do të fillojë edhe shpërndarja e librave nga koordinatori Hoti për nxënësit dhe në këtë rast po promovohet leximi dhe të lexuarit. Natyrisht vlera e librit është më e madhe sesa që flasim ne, por besoj se këta fëmijë do t'i lexojnë këta libra dhe do t'ua proklamojnë bashkëmoshatarëve të tyre që t'i lexojnë edhe ata", ka thënë Maliqi.

Si shenjë falënderimi për organizimin e garave, nxënësit e shkollës "Xhavit Ahmeti" i dhuruan koordinatorit Hoti disa punime dore. Komuna e Prishtinës ka pasur 3293 nxënës fitues në të gjitha nivelet e garës nacionale në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik si dhe në Dituri, 113 në nivelin komunal dhe 266 fitues në nivelin shkollor të garës.



## Shpërndahen kontejnerë për mbeturina për fshatrat Ticë, Plluzhinë dhe Likoc të Skenderajt



**Skenderaj, 3 shkurt (ER)** - Me qëllim të ngritjes së nivelit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Skenderajt, me përkrahjen e GIZ-it gjerman, Komuna e Skenderajt ka vazhduar shpërndarjen e kontejnerëve 120 litra në fshatrat Ticë, Plluzhinë dhe Likoc.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se në ditët e ardhshme, sipas planit të paraparë dhe mundësive financiare, do ta bëjnë edhe shpërndarjen e kontejnerëve në fshatrat e tjerë. "Mbulueshmëria me shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës sonë dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave është pjesë e angazhimit tonë kontinual. Për të krijuar një mjedis të pastër, duke ruajtur shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin në përgjithësi, secili nga ne duhet të kemi kujdes më të madh ndaj mjedisit. Falënderoj GIZ-in gjerman për gjithë përkrahjen e dhënë në fushën e menaxhimit të mbeturinave për komunën tonë", ka thënë kryetari Jashari.

# Në Kosovë nuk është regjistruar asnjë rast nga koronavirusi i ri

Të hënën është mbajtur mbledhja e dytë e Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ku u konstatua se janë përforcuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së koronavirusit të ri. Në këtë mbledhje u konfirmua se në Kosovë nuk ka të regjistruar asnjë rast nga koronavirusi i ri




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 3 shkurt** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se është duke monitoruar nga afër epideminë e sëmundjes respiratore të shkaktuar nga një koronavirus i ri i identifikuar për herë të parë në Wuhan, Provinca e Hubeit në Kinë.

Duke u bazuar në situatën aktuale epidemiologjike, informatat nga terreni, përgatitjet e institucioneve shëndetësore për t'u përballur me rastet eventuale të koronavirusit, mungesa e linjave ajrore direkte me Kinën, rreziku për depërtimin eventual të virusit në Kosovë vazhdon të mbetet i ulët.

IKShPK-ja, Departamenti i Epidemiologjisë po bën mbikëqyrjen aktive dhe gjurmimin e rasteve.

Të hënën u mbajt mbledhja e dytë e Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ku u konstatua se janë përforcuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së koronavirusit të ri.

Në këtë mbledhje u tha se është ngritur shkëmbimi i informatave ndërinstitucionale mes Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar, ShSKUK-së, AUV-së, QKMF-ve, Policisë së Kosovës, FSK-së dhe MAShT-it.

Instituti Kombëtar ka rekomanduar të gjitha institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Policinë e Kosovës, AUV-së dhe punëtorët shëndetësorë që ta ngritin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Gjatë kësaj mbledhje u potencua se çdo rast i dyshimtë i sëmundjes duhet të raportohet nga Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe institucionet e tjera shëndetësore publike dhe private, brenda 24 orëve (në kohë reale, sa më parë që është e mundshme me mjetin e komunikimit më të shpejtë) në qendrat rajonale të shëndetësisë publike dhe drejtpërsëdrejti në IKShPK.

U theksua se të gjitha institucionet shëndetësore do të vazhdojnë ta zbatojnë gatishmërinë e tyre për emergjencat shëndetësore, në përputhje me Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit (2005), rekomandimet e OBSh-së dhe ECDC-së. "Instituti Kombëtar do t'i informojë rregullisht institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë e Emergjencave dhe OBSh-në për ecurinë epidemiologjike të Novel Coronavirus (2019-nCoV) në Republikën e Kosovës. Në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është ekipi mjekësor, me të cilët jemi në kontakt të vazhdueshëm për mbikëqyrjen e situatës në rast të shfaqjes së personave të dyshimtë me sëmundje ngjitëse. Ekuipazhi i aeroplanit duhet t'i ndjekë procedurat operacionale të rekomanduara nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA) në lidhje me menaxhimin e personave të dyshimtë në sëmundje ngjitëse në bordin e aeroplanit. Situata epidemiologjike me koronavirus në botë (sipas ECDC: 3 shkurt 2020) në nivel global janë raportuar gjithsej 17 383 raste të konfirmuara me 2019 nCoV. Në Kinë gjithsej 17 220 raste të konfirmuara me 362 vdekje. Nga 362 raste të vdekjes, 361 janë në Kinë dhe një rast në Filipine. Jashtë Kinës: 163 raste të konfirmuara dhe 24 shtete të përfshira. Në Evropë janë raportuar 25 raste të konfirmuara në Gjermani, Francë, Itali, Mbretëri të Bashkuar, Rusi, Finlandë, Spanjë dhe Suedi", është theksuar në njoftimin e IKShPK-së.

## Nëntë masat e parandalimit të koronavirusit

1. Shmangia e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes.
2. Larja e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre.
3. Shmangia e prekjes së fytyrës dhe mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Hidhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave.
4. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit.
5. Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes.
6. Të evitohen vendet e mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.
7. Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë brenda 2 javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore.
8. Brenda mjediseve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës.
9. IKShPK-ja rekomandon të gjithë që të mos udhëtojnë drejt Kinës, nëse nuk e kanë të domosdoshme. Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të situatës epidemiologjike me koronavirus në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë ndryshime për të cilat do të informoheni me kohë.

## Më 8 dhe 9 tetor organizohet konferenca e dytë për gjeoshkencë në UMIB

**Mitrovicë, 3 shkurt (ER)** - Pas suksesit që ka arritur vitin e kaluar, konferenca me titull "Roli i gjeoshkencave në zhvillimin e qëndrueshëm", do të mbahet edhe sivjet, më 8 dhe 9 tetor 2020 në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB). Për këtë qëllim të hënën është mbajtur edhe takimi i Këshillit Organizativ (KO) ku, përveç UMIB-it, bëjnë pjesë edhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.



Në takim ishte i pranishëm edhe rektori i UMIB-it, Alush Musaj si dhe prorektorja Merita Shala, të cilët shprehën mbështetjen e plotë për Këshillin Organizativ që organizon një ngjarje të tillë me karakter shkencor. "Konferenca që u mbajt vitin e kaluar pati shënuar një sukses të madh dhe pati zgjuar interesim gjithandej. Duke pasur parasysh këtë sukses, mendojmë se është tepër me rëndësi që kjo të shndërrohet në një aktivitet tradicional në UMIB", ka thënë rektori Musaj.

Kryesuesi i Këshillit Organizativ, Sabri Avdullahi, e ka falënderuar rektorin Musaj dhe prorektoren Shala për mbështetje dhe falënderoi anëtarët e KO për angazhimin e tyre. Sipas tij, konferenca për gjeoshkencë po merr përmasa të një ngjarje shkencore të karakterit evropian, që është një gjë e madhe për UMIB-in.

Në konferencën për gjeoshkencë, vitin e kaluar, përveç studiuesve nga universitetet vendore, kanë qenë të pranishëm edhe studiues dhe shkencëtarë nga vende të ndryshme të Evropës, si nga Finlanda, Italia, Polonia, Turqia dhe Sllovenia. Gjithsej qenë regjistruar 86 pjesëmarrës, ku ishin dorëzuar gjithsej 75 abstrakte, prej të cilave ishin pranuar 52 sosh.

# Punëtorët e BERZh-it në Prishtinë nisin iniciativën për ta mbështetur AMC-në

Prishtinë, 3 shkurt (ER) - Punëtorët e Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në Prishtinë kanë nisur një fushatë bamirëse në kuadër të programit të kësaj organizate 'Iniciativa për komunitet'. Fushata ka për qëllim ta ndihmojë komunitetin në Kosovë, duke ndihmuar 'Action for Mothers and Children' për të ngritur fonde për implementimin e programeve. Të gjitha fondet që do të ngritën gjatë kësaj fushate përgjatë vitit 2020, pas plotësimit të kritereve raportuese, do të dyfishohen nga BERZh-i deri në vlerën 50 mijë euro, falë kësaj nisme të punëtorëve të BERZh-it.

Në një takim të përbashkët në mes të AMC-së dhe BERZh-it u diskutuan shumë ide se si do të ngritën fonde përgjatë këtij viti si dhe u pajtuan që t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre me qëllim që të jenë sa më efikas dhe të ngritin sa më shumë fonde. "Action for Mothers and Children angazhohet vazhdimisht përmes projekteve e programeve të ndryshme për ta zvogëluar numrin e vdekshmërisë së foshnjave dhe përmirësimin e shëndetit të nënave dhe fëmijëve në Kosovë. Të gjitha fondet që do të ngritën përgjatë vitit 2020 do të ndihmojnë programet e ndryshme që AMC është duke i implementuar, por fokus të veçantë do t'i jepet fuqizimit dhe zgjerimit të qendrave informative për shëndetin e grave, duke i hapur këto qendra edhe në komuna të reja të Kosovës, si dhe do të ndihmohen institucione të ndryshme shëndetësore me pajisje të reja shëndetësore dhe medikamente", është theksuar në komunikatën e 'Action for Mothers and Children'.

AMC-ja ka vlerësuar se është jashtëzakonisht mirënjohëse ndaj punëtorëve të BERZh-it që kanë përzgjedhur ta mbështesin organizatën e tyre këtë vit, duke ndihmuar kështu ta përmbushim misionin e tyre për përmirësimin e jetës së nënave dhe fëmijëve në Kosovë.




# Klubi i Prodhuesve uron qeverinë e re: Prioritet të jetë zhvillimi ekonomik

**Prishtinë, 3 shkurt (ER)** - Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka përshëndetur formimin e Qeverisë LV - LDK dhe beson se kjo qeveri do të ketë prioritet hartimin e një plani afatgjatë i cili do ta mundësojë zhvillimin ekonomik dhe do ta fuqizojë sektorin e prodhimit. "Po ashtu, shpresojmë se qeveria e re do ta vazhdojë reformën ligjore e cila do ta avancojë edhe më tutje sektorin e prodhimit dhe do të mundësojë hapjen e rrugëve të reja për inovacion dhe ekonomi të qëndrueshme. Prioritetet e qeverisë në këtë mandat duhet të jenë: sundimi i rendit dhe i ligjit, përmirësimi i infrastrukturës, përmirësimi i furnizimit me energji elektrike, adresimi i hendekut të fuqisë punëtore, financimi dhe përkrahja e eksportit, si dhe përkrahja e kompanive kosovare që të bëhen më konkurruese me vendet e rajonit", është thënë në komunikatën e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Klubi i Prodhuesve ka shtuar se do të vazhdojë edhe më tutje të jetë një urë lidhëse në mes të prodhuesve dhe institucioneve shtetërore dhe do të vazhdojë të kontribuojë në fuqizimin e sektorit të prodhimit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.



# Telekomi i Kosovës, mes privatizimit dhe falimentimit

PRISHTINË, 3 SHKURT - Telekomi i Kosovës, dikur kompania më fitimprurëse në vend, që nga viti 2015 po vazhdon të përballet me probleme të mëdha financiare dhe operative.
Ministri i Zhvillimit Ekonomik nga përbërja e kaluar e Qeverisë së Kosovës, Valdrin Lluka, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se rruga e vetme për shpëtimin e Telekomit nga kriza financiare në të cilën është futur është privatizimi.
Sipas tij, Telekomi nuk mund të vazhdojë të operojë si i tillë, pasi që ka humbje të mëdha vjetore dhe atë deri në 15 milionë euro në vit. Megjithatë, ai thotë se i mbetet qeverisë në ardhje të vendosë se si do t'i qaset kësaj ndërmarrje. "Privatizimi është rruga e vetme dhe e duhur për Telekomin e Kosovës ashtu siç edhe kam menduar që nga fillimi, ashtu siç edhe kemi filluar procedurat, ashtu siç kemi pasur edhe ndihmë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të cilët na kanë dhënë një grant për financimin e ristrukturimit të Telekomit dhe përgatitjes së kompanisë për privatizim. Ky proces është duke ndodhur, mirëpo me politikën në ardhje nuk jam i sigurt se sa do të ecë tutje ky proces", ka pohuar Lluka.
Telekomi i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile "Vala". Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 100 për qind të aksioneve të Telekomit të Kosovës.
Një privatizim i mundshëm po kundërshtohet nga Sindikata e Punëtorëve të Telekomit të Kosovës. Lamih Balaj, kryetar i kësaj sindikate, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se privatizimi në këtë kohë është i gabuar. "Pse duhet të shkohet në privatizim në këtë fazë kur Telekomi po përballet me probleme financiare të cilat mund të zgjidhen. Telekomi ka qenë një kompani me një vlerë mbi 1 miliard euro. Po tentohet të privatizohet Telekomi në mënyrë që të mbyllet krimi që është bërë në këtë ndërmarrje. Nuk do ta lejojmë privatizimin. Telekomi mund të kthehet në treg në rast se qeveria që vjen nuk e proklamon falimentimin, por kërkon përgjegjësi nga menaxhmenti", ka thënë ai.
Telekomi i Kosovës, sipas Sindikatës së Punëtorëve, është futur në krizë financiare si pasojë e mosmenaxhimit të duhur, nënshkrimit të kontratave të dëmshme dhe keqpërdorimeve të shumta që janë bërë ndër vite.
Së fundmi, Telekomi i Kosovës ka kërkuar ndihmë nga Qeveria e Kosovës në një vlerë prej 5 milionë eurosh. Kjo ndihmë është kërkuar për rritje të kapitalit si masë emergjente e detyrueshme për ta siguruar funksionimin normal të Telekomit. Megjithatë, në mbledhjen e fundit të Qeverisë në detyrë të Kosovës, kjo kërkesë e bordit të Telekomit të Kosovës nuk është aprovuar për shkak të, siç është thënë, nuk ka mjete aktualisht që mund t'i ndahen kësaj ndërmarrjeje.




Qeveria e Kosovës në janar të vitit të kaluar pati marrë vendim që të privatizohet kjo kompani. Ndërsa në gusht të vitit 2019 kishin filluar takimet me kompaninë Detecon International GmbH dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për privatizimin e Telekomit të Kosovës.
Sipas projeksioneve të Qeverisë së Kosovës, privatizimi përfshinë pjesën vendimmarrëse të Telekomit, me rreth 51 për qind, duke qëndruar aksionarë për pjesën tjetër.
Valdrin Lluka thotë se privatizimi do të krijonte edhe për Qeverinë e Kosovës të ardhura financiare si dhe shërbime më të mira për konsumatorët. "Po flasim për privatizim duke biseduar me brende ndërkombëtare, siç kam qenë në bisedime, siç kanë treguar interesime, si telefonia gjermane, austriake dhe kompani të tjera, prandaj nëse shkohet në një rrugë të tillë, kjo jo vetëm se përmirëson gjendjen financiare të Telekomit, por edhe qeveria, duke mbetur si aksionare, do të përfitojë më shumë nga devidenta në të ardhmen si dhe qytetarët do të kenë shërbim më të mirë të telefonisë mobile, përderisa operohet nga një kompani ndërkombëtare", është shprehur Lluka.
Aktualisht, shton Lluka, nuk mund të dihet vlera e saktë që mund të ketë Telekomi i Kosovës por, sipas tij, pasuria më e madhe që ka Telekomi dhe që ia rrit vlerën për privatizim, është numri i madh i klientëve që ka kompania dhe atë mbi gjysmën e tregut në vend.
Telekomi i Kosovës i ishte nënshtruar në të kaluarën dy herë procesit të privatizimit, mirëpo asnjëri proces nuk është finalizuar me sukses.
Në rastin e privatizimit të 75 për qind të aksioneve të Postës dhe Telekomit të Kosovës, në vitin 2013 kompania "Axos Capital" ishte shpallur fituese, me një vlerë prej 277 milionë eurosh. Por, i gjithë procesi ishte anuluar më pastaj.

# Kosova ka mbi dy milionë përdorues të telefonisë mobile

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka njoftuar se numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të tremujorit të parë (TM3-2019) ka arritur në 2,100,218, përkatësisht për 2.46 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM3-2018). Ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak TM2-2019 numri i përdoruesve është 11.96 për qind më i lartë (ose 224 381 përdorues).
Ngjashëm me numrin e përdoruesve, edhe penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile në periudhën raportuese ka shënuar rritje në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa rritje të lehtë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2018). Penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile tani është në nivelin 115.68 për qind në raport me numrin e popullsisë.
Të dhënat për normën e penetrimit të telefonisë fikse në Kosovë në këtë tremujor janë 3.12 për qind. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Kosovë vazhdon të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e rajonit, e sidomos me shtetet e BE-së, ku penetrimi sillet nga 10 për qind në rreth 40 për qind, respektivisht.
Në këtë periudhë, TM3 2019, është shënuar rënie e lehtë e parapaguesve për -1.88 për qind krahasuar me tremujorin paraprak dhe rënie në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar për 7.92 për qind. "Ndarja e përdoruesve të telefonisë fikse në individual dhe të biznesit për periudhën TM1 2015 deri në TM3 2019 është paraqitur në figurën e mëposhtme. Nga të dhënat në figurën mund të vërehen ndryshimet në strukturën e



parapaguesve të telefonisë fikse, përkatësisht rënie e vazhdueshme për parapaguesit individualë në raport me parapaguesit e bizneseve", thuhet në përmbledhjen e indikatorëve kryesorë të komunikimeve elektronike "pasqyrë e tregut të komunikimeve elektronike" për TM2-2019.
Numri i linjave të internetit me qasje fikse fikse brezgjerë deri në TM3 2019, i raportuar nga operatorët, shënon shifrën 352,659 parapagues të internetit. Nga kjo vërehet rritje prej 24,620 parapagues apo 7.50 për qind në krahasim me TM2 2018, respektivisht një rritje më të theksuar prej parapaguesve apo 15.41 për qind në krahasim me periudhën TM3 2018.
Ndërsa penetrimi i internetit përmes qasjes fikse brezgjerë në internet për ekonomi familjare është 118.7 për qind, përkatësisht penetrimi i internetit sipas banorëve (për 100 banorë) rezulton të jetë 19.42 për qind.
Numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit mobil (Mobile Broadband) apo qasja në internet përmes rrjetit mobil 3G dhe 4G në periudhën TM3 2019 ka arritur në 1,299,415 përdoruesish e që shënon një rënie 33.20 për qind prej krahasuar me TM3 2018.
Trendi i numrit të parapaguesve të qasjes në internet përmes rrjetit mobil që nga fillimi i ofrimit të këtyre shërbimeve në treg është karakterizuar me një rritje të vazhdueshme, edhe pse në periudhën TM4 2016 është vërejtur një rënie e lehtë.
Në periudhën raportuese (TM3 2019) vërehet rritje e peneterimit për qasjen mobile dhe në atë fikse rritje e lehtë.

# Përfundon trajnimi për turizëm në Kamenicë

Kamenicë, 3 shkurt (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, në vazhdën e aktiviteteve të veta ka vazhduar ta mbështesë projektin e organizatës joqeveritare "Proactive", me të cilën kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi.
Në kuadër të projektit "Rikthimi i prosperitetit përmes turizmit dhe trashëgimisë kulturore" më 1 dhe 2 shkurt është mbajtur moduli i katërt dhe njëkohësisht i fundit i trajnimit për turizëm.
Trajnimi është mbajtur nga profesori Idriz Kovaçi dhe profesoresha Alberta Tahiri, ku janë trajtuar tema të ndryshme si: raste studimi nëpër botë rreth turizmit dhe zhvillimi i planit të biznesit.
Po ashtu është bërë një vizitë në Roganë te familja e Xhevdet dhe Nexhmije Kallaba - "Kallabaguesthouse", të cilët tash e një kohë merren me turizëm.
Kallaba ka treguar se si ai i organizon guidat turistike, sidomos për gjermano-folësit. Ai ka thënë se turistët vijnë me shumë paragjykime për shqiptarët, por kur mirëpriten në Kosovë ndahen shumë të kënaqur.
Në kuadër të këtij trajnimi është bërë edhe certifikimi i kandidatëve në ambientet e njërit prej fshatrave të përzgjedhur për turizëm rural, në fshatin Tugjec te "Kulla".



# Senatori francez vjen në Gjilan për ta forcuar bashkëpunimin në zhvillimin ekonomik

Gjilan, 3 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune ish-ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Francës, senatorin Jean-Marie Bockel, i cili shoqërohej nga ish-drejtori për Zhvillim Ekonomik i Gjilanit, Agim Zuzaku. Pasi e ka falënderuar për vizitën, kryetari Haziri ka thënë se vizita e senatorit Bockel shënon një nisje për bashkëpunim në kuadër të zhvillimit ekonomik lokal. "Faleminderit për ardhjen në Gjilan dhe për krejt atë besim të qytetarëve të Luterbach nga Strasburgu, që prej vitit 2000, për qytetin tonë. Shoqata MAN po vazhdon të kontribuojë për zhvillimin e gjuhës frënge dhe bashkëpunim mes rinisë së dy qyteteve. Vizita e sotme e senatorit Bockel shënon interesimin për një bashkëpunim dhe zhvillim më të madh lokal ekonomik, ku përmes sjelljes së investitorëve dhe shkëmbimit do të përpiqemi t'i arrijmë qëllimet tona", ka deklaruar Haziri.



Ndërsa ish-ministri i Mbrojtjes së Republikës së Francës, senatori Jean-Marie Bockel, ka thënë se po e viziton këtë komunë për ta favorizuar partneritetin ekonomik në mes të Alsaces dhe Gjilanit. "Kemi ardhur me idenë për ta favorizuar partneritetin ekonomik të investitorëve në mes të qytetit të Alsaces dhe Gjilanit e, ndoshta, edhe me partnerë financiarë ndërkombëtarë. Lidhur me këto arsye ne kemi dashur që të njihemi më mirë. Ne dëshirojmë që qyteti juaj të zhvillohet në vazhdimësi sepse keni mjaftueshëm potencial. Shteti i Kosovës ka qytetarë të motivuar dhe kushte të mira për investime në infrastrukturë", ka thënë senatori Jean-Marie Bockel.
Kreu i Gjilanit në javët e ardhshme pritet të realizojë një vizitë në Francë, për konkretizim të bashkëpunimit në aspektin ekonomik.

# Punë praktike me mundësi punësimi për 100 studentë të diplomuar nga Fakulteti Teknik në Mitrovicë

Mitrovicë, 3 shkurt (ER) - Udhëheqësi i Njësisë së të Drejtave të Njeriut, Fitim Rama, është takuar me drejtorin e Zyrës Rajonale të Punësimit në Mitrovicë, Besmir Salihu, me të cilin kanë biseduar në lidhje me zbatimin e projektit "Skema e praktikës për të diplomuarit nga fakultetet teknike", i realizuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me GIZ-in gjerman dhe Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë. Me këtë rast, drejtori i Zyrës Rajonale të Punësimit, Besmir Salihu, ka potencuar se kjo skemë e praktikës do të përfshijë 100 studentë të diplomuar nga Fakulteti Teknik në Mitrovicë, të cilët do ta kenë mundësinë e praktikës në vend të punës dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për përfshirje në tregun e punës. "Sipas memorandumit që është nënshkruar nga palët, trajnimi në vendin e punës do të zgjasë gjashtë muaj. Palët e përfshira në këtë memorandum janë pajtuar të punojnë së bashku për ta përcaktuar dhe zbatuar skemën e praktikës për të diplomuarit deri në moshën 35 vjeç dhe për studentët të cilët kanë përfunduar studimet gjatë viteve 2018-2019", ka thënë Salihu.






# Komuna e Prizrenit prezantohet në Panairin e Turizmit 'Roma Travel Show'

Prizren, 3 shkurt (ER) - Në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit "Roma Travel Show", ku po marrin pjesë mbi 200 ekspozues me mbi 500 destinacione të ndryshme turistike, është duke u prezantuar edhe Komuna e Prizrenit nëpërmjet Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik. Në këtë panair janë prezantuar vlerat e trashëgimisë kulturore dhe pasuritë e shumta natyrore e historike të qytetit të Prizrenit nga ana e drejtoreshës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz. Nëpërmjet kësaj drejtorie pjesëmarrëse në këtë panair janë edhe disa biznese hoteliere, si dhe mjeshtër të artizanateve dhe punimeve të dorës nga Komuna e Prizrenit.

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (17)

# Struktura e atomit ndryshon tërësisht nga ajo që njeh fizika e tanishme



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Si shembull më të thjeshtë e marrim atomin e hekurit, rreth të cilit më së shumti shkruhet në këto botime. Në bërthamën e atomit ndodhen 26 protone të ngarkuara me ngarkesa pozitive, 30 neutrone neutrale. Po t'i transformojmë këto fenomene te sistemi ynë diellor, i bie se në brendësi të sistemit tonë diellor ndodhen 26 diell që posedojnë fusha magnetike dhe 30 venera dhe merkure që nuk posedojnë fusha magnetike. Kurse rreth bërthamës së atomit rrotullohen 26 elektrone me ngarkesa negative, që i bie se rreth 26 diellave, 30 venerave dhe merkurëve rrotullohen edhe 26 trupa qiellorë sikur toka apo një trup tjetër që posedon fushë magnetike.

Por konfuziteti rritet edhe më shumë kur themi se 26 protonet kanë masë dhe ngarkesë të njëjtë, çka do të thotë se 26 diellat kanë madhësi dhe fusha magnetike të njëjta. Gjithashtu edhe 30 neutronet janë të njëjta çka do të thotë se edhe 30 planete si venera dhe merkuri janë të njëjtë dhe nuk posedojnë fusha magnetike. Por nëse kësaj i shtohen edhe 26 elektrone me ngarkesa të njëjta elektrike që rrotullohen rreth bërthamës së atomit, i bie se 26 trupat qiellorë duhet të jenë të njëjtë dhe të kenë fusha magnetike të njëjta, sikur toka apo ndonjë trup i tjetër qiellor që rrotullohen rreth 56 trupave qiellorë (diellave, venerave dhe merkurëve). Kjo nuk ka asnjë logjikë shkencore, të thuhet sot se protonet kanë madhësi të njëjtë dhe ngarkesa elektrike të njëjta, ngjashëm vlen edhe për ngarkesat dhe masat e elektroneve, si dhe masat e neutroneve, si dhe vetë këto të dhëna e kanë ndarë fizikën në dy fizika.

Në natyrë nuk mund të gjemë asnjëherë trupa identik të njëjtë ashtu sikur paramendohet për protonet elektronet dhe neutronet. Njerëzit në tërë botën nuk janë të njëjtë, nuk kanë masa dhe lartësi të njëjtë, pra, njëjtë vlen edhe për kafshë bimë, por edhe ç'do element në natyrë. Kjo vërehet edhe nëse e marrim një sasi rëre, grimcat duken identike por mikroskopi e jap të kundërtën. Prandaj, duke e parë se ka një ngjashmëri në mes makrobotës dhe mikrobotës, si dhe duke u bazuar në zbulimin tim të fushës antimagnetike, fushës antielektrostatike dhe fushës magnetike simetrike përmes fenomenit të rigjenerimit vijmë në përfundim se struktura e atomit ndryshon tërësisht nga ajo që e njeh fizika e tanishme.

Kështu që sot apo më vonë do të vërtetohet se në brendësi të një atomi ekzistojnë protone, dhe elektrone të cilat posedojnë masa dhe ngarkesa të ndryshme në mes veti, si dhe neutrone me masa të ndryshme.

Në qendër të bërthamës ekziston një dhe vetëm një proton që ka një ngarkesë më të lartë elektrike dhe masë më të madhe, kurse rreth këtij protoni rrotullohen të gjitha protonet neutronet dhe elektronet, ashtu sikur rreth diellit që rrotullohen të gjithë trupat qiellorë qoftë ata trupa që posedojnë fusha magnetike apo ata trupa që nuk posedojnë fusha magnetike.

Si mund të thuhet sot se protonet dhe elektronet kanë vlera të njëjta të ngarkesave elektrike pozitive dhe negative, sepse shumë mirë dihet se sot nuk ekziston një aparaturë moderne që mund të depërtoi në brendësi të atomit dhe t'i matë ngarkesat elektrike një nga një të protoneve dhe elektroneve. Por ciklonet dhe tornadot te ngarkesat elektrike të protoneve, neutroneve dhe elektroneve kur ndodhen në fusha të ndryshme magnetike gjatë testeve të ndryshme mund të marrin nivele energjetike të caktuara, me çka jep rezultat kundër produktiv mbi vlerën e ngarkesave elektrike, dhe aspak këto të dhëna nuk përputhet me realitetin, dhe ky nuk është një rezultat i vërtetë se sa është ngarkesa elektrike e elektroneve dhe protoneve, thjesht ne gjendje të qetësisë nuk i kemi mat këto ngarkesa.

Aq më konfuze është ngarkesa elektrike e njëjtë sikur te protonet ashtu edhe te elektronet, pasi shkencërisht mendohet se masa e protonit është rreth 1835 herë më e madhe se sa masa e elektronit. Shtrohet pyetja se si ka mundësi të kenë ngarkesa elektrike me vlera të njëjta pozitive dhe negative protoni dhe elektroni.

**Shembull 1.**

Përndryshe po ta krahasojmë me sistemin tonë diellorë masat e dy trupave qiellorë dhe fushat magnetike të tyre, natyra e flet tërësisht të kundërtën. Shembull do ta marrim planetin e jupiterit ku ka një masë 318 here më të madhe se sa masa e tokës, kurse intensiteti i fushës magnetike të jupiterit është afërsisht 10 here më i madh se sa




Fig 30




Fig 31




Fig 33

intensiteti i fushës magnetike të tokës. Shiko figurën 30.

Për t'i afruar raportet e masave në mes protonit dhe elektronit në njërën anë, dhe masën e tokës dhe jupiterit në anën e tjetër, atëherë masa jupiterit për ta pasur vlerën e 1836 më të madhe se sa masa e tokës, do të duhen 5,77 jupitera të kenë masën për 1836 herë më e madhe se sa masa e tokës. Po ta llogarisim intensitetin e fushave magnetike i bie se intensiteti i fushës magnetike të tokës në këtë rast është për 57.7 herë më i vogël se sa intensiteti i fushave magnetike të 5,77

jupiterave.

**Shembull 2**

Pasi kemi të bëjmë me ngarkesa pozitive dhe negative me vlera të njëjta, në rastin e dytë e marrim një bateri të veturës 12 V, e cila ka polin pozitiv dhe negativ. Po të hapet bateria brenda ka tërësisht përbërje të njëjtë si nga poli pozitiv ashtu edhe nga poli negativ. Prandaj, gjysma e baterisë është pozitive dhe gjysma negative. Prandaj, masa e baterisë është e barabartë sikur te poli pozitivë (+) ashtu edhe te poli negativë (-). Por edhe në se e masim rrymën elektrike me multimetër në të dy anët del vlerë e njëjtë (+ 12) dhe (-12V).

Pra kjo që të thuhet sot se masa e protonit është 1836 herë më e madhe se masa e elektronit, kurse si protoni edhe elektroni kanë vlera të ngarkesave pozitive dhe negative të barabarta, absolutisht nuk përputhet me ligjet e natyrës dhe nuk ka asnjë logjikë shkencore. Këto të dhëna të pa argumentuara në formë shkencore, dhe të bazuara në ligjet e natyrës ishin dhe mund të jenë tragjike për të tanishmen dhe të ardhmen, sepse bazuar në këto të dhëna sot kryhen teste me protone, neutrone dhe elektrone, pa pasur asnjë ide se mund të ngacmohen fenomenet që janë sqaruar në këto botime. Bazuar në këto të dhëna që janë logjike dhe bazohen në ligjet e natyrës, atëherë strukturës së brendshme të atomit i japin një kuptim më ndryshe dhe më real me natyrën: Në qendër të atomit ndodhet një dhe vetëm një proton që ka një masë më të madhe dhe ngarkesë me të lartë elektrike se sa të tjerët, kurse rreth këtij protoni mund të rrotullohen protone dhe elektrone me masa dhe ngarkesa të ndryshme elektrike, si dhe neutrone të pangarkuara, kurse rreth protoneve dhe elektroneve mund të rrotullohen neutrone të pa ngarkuar me masa të ndryshme ashtu sikur shihet në figurën 31.

**Veprimi i forcave tërheqëse dhe shtytëse në mes makrotrupave dhe mikrotrupave**

Bazuar në të dhënat e mëparshme, duke i marrë parasysh fushat magnetike dhe elektrostatike simetrike, mund të themi se në mes trupave te makrobota dhe mikrotrupave te mikrobota forcat e veprimit ndahen në dy grupe: 1) Forca tërheqëse të dobëta, a) Forca tërheqëse të dobëta te mikrobota në mes ngarkesave elektrike të protonit (+) elektronit (-) dhe neutroni (n), si dhe forca tërheqëse të dobëta te makrobota në mes fushave magnetike të trupave qiellorë. b) Forca shtytëse të dobëta te mikrobota në mes të fushës antielektrostatike të protonit [←(-E P )] me fushën elektrostatike të elektronit [→(-E E )], si dhe fushës antielektrostatike të elektronit [←-(-E E )]=[←(+E E )] me fushën elektrostatike të protonit [→(+E P )]. 2) Forca tërheqëse të forta, a) Forca tërheqëse të forta te mikrobota në mes cikloneve dhe tornadove të protoneve dhe elektroneve, si dhe forca tërheqëse të forta te makrobota në mes të cikloneve dhe tornadove të trupave qiellorë. b) Forca shtytëse të forta te mikrobota në mes fushave antielektrostatike të protoneve dhe elektroneve, si dhe te makrobota në mes fushave antimagnetike të trupave qiellorë. Prandaj, sikur te makrobota ashtu edhe te mikrobota forcat e forta tërheqëse dhe forcat e forta shtytëse, janë forcat kryesore që e mbajnë stabil sikur mikrobotën ashtu edhe makroboren.

**Forcat e forta shtytëse te makrobota dhe mikrobota**

Forca të forta shtytëse te makrobota janë fushat antimagnetike, kurse te mikrobota janë fushat antielektrostatike, ashtu sikur shihet në figurën 32.

**Forcat e forta tërheqëse te makrobota dhe mikrobota**

Forca të forta tërheqëse te makrobota janë forcat në mes cikloneve dhe tornadove të trupat qiellorë, si shembull në mes tokës dhe diellit figura 33.

Ashtu sikur është cekur në botimet e fizikës simetrike 2019, ta lexosh nuk do të thotë se do ta kuptosh, dikush do ta kuptojë, mos tani më vonë, por shumëkush asnjëherë. Por deshi fati që me përkrahjen e parezervë të gazetës "Epoka e re", u bë i mundur botimi i këtyre shkrimeve të mia, kurse në mesin e këtyre lexuesve ndodh edhe mrekullia: një shkencëtar shumë i njohur për opinionin vendor dhe më gjerë, e kuptoi botën e brendshme të këtyre shkrimeve dhe sot është një përkrahës i pandashëm i imi, dhe bashkëpunëtor i ngushtë në jetësimin e fizikës simetrike.

Ai ka kapacitetin për ta bërë të njohur teorinë time në qarqe shkencore ndërkombëtare, gjë që unë një mundësi të tillë nuk e kisha ashtu sikur është sqaruar në fizikën simetrike 2019.

Historia do ta tregojë se po ky shkencëtar i pakrahasueshëm do të mbetet një yll i fizikës simetrike.

*(FUND)*

# Pse Ajvoa është e rëndësishme në garën për Shtëpinë e Bardhë?

Tubimet në Ajova datojnë nga viti 1840, por nga viti 1972 ato e nisin garën për emërimin presidencial. Fituesi që del nga to merr hov dhe vëmendje mediatike, por historia tregon se kjo nuk është gjithmonë përparësi pasi që te Partia Republikane, tre të nominuar presidencialë kanë fituar në Ajova, te Partia Demokrate shtatë

**Uashington, 3 shkurt -** Ngjarja e parë që do të ndihmojë në zgjedhjen e kandidatëve për president të Shteteve të Bashkuara ndodh të hënën në shtetin e Ajovas. Votuesit demokratë dhe republikanë do t'i zgjedhin të preferuarit e tyre për garën drejt Shtëpisë së Bardhë. Fitorja në Ajova nuk ia garanton asnjërit nominimin, por u jep një shtysë të rëndësishme.

Presidenti aktual, Donald Trump, duket qartë se do të jetë kandidati republikan, por janë 11 persona që do të garojnë për nominimin e Partisë Demokratike.

Të hënën në Ajova njerëzit do të mblidhen në bodrumet e kishave, në palestrat e shkollave, madje edhe në shtëpi private për ta treguar mbështetjen e tyre për kandidatët.

Partia Demokratike do të mbajë tubime të tilla në rreth 1 700 pika. Ajova, Nevada dhe Vajoming janë shtetet e vetme që mbajnë këso takimesh - 47 të tjerat kanë zgjedhje paraprake, në të cilat votuesit votojnë për kandidatët që i pëlqejnë, ka njoftuar rfe.

Tubimet në Ajova datojnë nga viti 1840, por nga viti 1972 ato e nisin garën për emërimin presidencial. Fituesi që del nga to merr hov dhe vëmendje mediatike, por historia tregon se kjo nuk është gjithmonë përparësi. Te Partia Republikane, tre të nominuar presidencialë kanë fituar në Ajova, te Partia Demokrate shtatë.

Te republikanët, vetëm një president - George W. Bush - ka fituar në tubimet e tilla në Ajova. Te demokratët, ndërkaq, dy fitues të Ajovas janë bërë presidentë: Jimmy Carter dhe Barack Obama.

Përfaqësuesit e fushatës do ta bëjnë prezantimin final të kandidatëve përkatës. Pas kësaj, njerëzit do të mblidhen me të tjerët që mbështesin të njëjtin kandidat.

Kandidatët që kanë më pak se 15 % të mbështetjes nga numri total i njerëzve në dhomë, konsiderohen "të paqëndrueshëm". Ndjekësit e tyre, në këtë pikë, mund të shkojnë te grupi i një kandidati tjetër.

Pas raundit të dytë, të gjithë kandidatëve me më shumë se 15% të mbështetjes u ndahen disa delegatë, që do t'i përfaqësojnë ata në etapa të mëvonshme të procesit të nominimit.

Ajova ka një nga proceset më komplekse, që përfshijnë tubimet e 3 shkurtit, pastaj kongreset e qarqeve dhe konventën e rrethit.

Këtë vit 41 delegatët përfundimtarë do të zgjidhen më 13 qershor në konventën e shtetit. Në korrik ata pastaj do të kalojnë në Konventën Kombëtare Demokratike, në të cilën delegatët që përfaqësojnë të gjitha shtetet dhe territoret amerikane zgjedhin kandidatin presidencial të partisë.

Këtë vit, një kandidati të Partisë Demokratike i duhen 1,991 vota të delegatëve për të fituar nominimin e partisë.

Janë 11 demokratë që synojnë të bëhen kandidatë presidencialë të partisë. Sipas sondazheve të opinionit, Bernie Sanders, senator nga Vermonti, dhe Joe Biden, ish-nënpresident, janë në mesin e kandidatëve kryesorë.

Elizabeth Warren, senatore nga Masaçusets, është një tjetër kandidate që del mirë në sondazhe.

Dyzetenjë delegatët të përfshirë në Ajova, janë vetëm një pjesë e numrit total që i duhet një kandidati për t'u bërë i nominuar i Partisë Demokratike.

Kjo bën që disa kritikë të thonë se rëndësia e Ajovas është e mbivlerësuar.

Tubimet në Ajova shpesh kritikohen edhe për pjesëmarrjen e popullsisë kryesisht të bardhë dhe, në këtë mënyrë, thuhet se nuk e përfaqësojnë gjithë vendin.

Të tjerët thonë se këto tubime, ndryshe nga zgjedhjet paraprake, u kërkojnë njerëzve të jenë të pranishëm fizikisht për disa orë. Sipas Unionit të Lirive Civile Amerikane, "kjo e bën pjesëmarrjen të vështirë për njerëzit që nuk kanë ose nuk mund ta përballojnë kujdesin për fëmijët, për njerëzit me aftësi të kufizuara, për njerëzit që nuk kanë transport ose për njerëzit që punojnë në mbrëmje".

Zgjedhjet paraprake do të mbahen në Nju Hempshir më 11 shkurt, në Nevada më 20 shkurt dhe në Karolinë të Jugut më 29 shkurt.

Më 3 mars do të jetë "Super e Marta", kur zgjedhjet paraprake mbahen në 14 shtete. Më shumë se një e treta e popullsisë amerikane pritet të votojë më 3 mars.

Konventa Kombëtare Demokratike do të mbahet më 13-16 korrik, ndërsa zgjedhjet presidenciale më 3 nëntor.



MICHAEL REYNOLDS (EPA-EFE)

## Nisin bisedimet e ndërmjetësuara nga OKB-ja për Libinë



Gjenevë,Zyrtarët ushtarakë nga fraksione rivale në konfliktin e Libisë, kanë nisur bisedimet e ndërmjetësuara nga Kombet e Bashkuara në Gjenevë, me qëllim të arritjes së armëpushimit pas 10 muajve të luftimit në periferi të kryeqytetit, Tripoli.

I ashtuquajturi "Komisioni i Përbashkët Ushtarak i Libisë" përfshin pesë zyrtarë të lartë të komandantit, Khalifa Haftar dhe pesë zyrtarë të Qeverisë së njohur ndërkombëtarisht në Tripoli.

Haftar ka nisur ofensivë nga muaji prill për të marrë kontrollin e Tripolit.

Si pasojë e këtyre luftimeve janë zhvendosur më shumë se 150,000 persona, pa harruar edhe përfshirjen e fuqive të huaja në to.

Bisedimet ushtarake vijnë dy javë pas një samiti ndërkombëtar të mbajtur në Berlin, i cili ishte fokusuar në gjetjen e një zgjidhjeje politike, dhe zbatimin e embargos për armët që është shkelur së fundmi.

Haftar mbështetet nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Jordania, Rusia dhe Franca, derisa qeveria përkrahet nga Turqia.

Diplomatët kanë thënë se bisedimet e Gjenevës synojnë të ndërtojnë besim dhe të krijojnë një mekanizëm për vëzhgim të armëpushimit.

Këto bisedime janë duke u ndërmjetësuar nga përfaqësuesi special i Kombeve të Bashkuara, Ghassan Salame.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues



# Jonathan Franzen: S'do të doja të shkruaja gjëra që s'janë letërsi

Intervistoi: Isaac CHOTINER

**A keni menduar ndonjëherë të shkruani një libër për racizmin?**
E kam menduar, por është rrëfim që më vë në siklet ta bëj, s'kam asnjë mik me ngjyrë. S'jam dashuruar ndonjëherë me një vajzë me ngjyrë. Po të kishte ndodhur, do të kisha guxuar të shkruaja.

**Po thoni që s'jeni dashuruar asnjëherë me një zezake?**
Ashtu është. Gruan s'e kam me ngjyrë. Unë shkruaj për personazhe dhe duhet ta dua një personazh në mënyrë që të shkruaj për të. Nëse s'ke pasur përvojë vetjake ta duash një kategori individësh, një njeri të një race tjetër, një njeri shumë fetar, dikë që mbart cilësi që përbëjnë dallime të mëdha mes njerëzve, mendoj se është e vështirë të guxosh apo madje të duash të shkruash, të hysh plotësisht në brendësi të këtij personi. Në rastin e romanit *Dëlirësia*, kisha shumë material që lidhej me Gjermaninë. Kisha kaluar dy vjet e gjysmë atje. E njihja letërsinë gjermane mirë, por s'shkruaja dot për Gjermaninë, sepse s'kisha asnjë mik gjerman. Mundësia e vetme për të qenë në gjendje të shkruaja për të ishte fakti që befas zura miqësi me miq gjerman të cilët i doja me të vërtetë. Pas kësaj nuk isha një i huaj armiqësor, por një i familjes dhe miqësor.

**Por, megjithatë, ka personazhe në romanet tuaja të cilët nuk të bëjnë fare t'i duash.**
Eh, po si e përkufizon ti dashurinë?

**Epo, realisht po mendoja, çfarë ju kuptoni me dashuri?**
Bëj të pamundurën të mos dëgjoj atë që njerëzit thonë për mua. Në fillim të romanit kjo ide i vjen Edlirës dhe ajo fillon bën një listë të gjërave që përbënin dashurinë për nënën e saj. Ndiente keqardhje, vuante për të, ndiente një tërheqje trazuese ndaj trupit të saj, dëshironte që ajo të ishte e lumtur, ishte e shtrenjtë për të. Mendoj se ka të bëjë me të pranuarit që një njeri tjetër është i tillë dhe ta kuptosh këtë plotësisht. Dhe të duash të jesh me këtë person, të të pëlqejë të jesh me këtë person pavarësisht nga të metat. Kështu, ashtu si te romani *Dëlirësia*, Andrea ka disa tipare të papëlqyeshme, por për shkak se ka pasur një fëmijëri të trazuar dhe për shkak se është përballur gjatë gjithë jetës me sëmundjen e tij mendore dhe meqenëse unë kam njohur njerëz të tillë ndërkohë që ai s'ishte thjesht një njeri i keq, luftonte pareshtur për t'u bërë njeri më i mirë. Mua më prekte kjo dëshirë e tij, e cila mendoj se është dëshirë e vërtetë, të duash të jesh njeri më i mirë. Kjo ishte pika e lidhjes sime me të. Pavarësisht nga ajo që bën, ai është i vetëdijshëm për atë që po bën, mendon për këtë dhe përpiqet të jetë i ndershëm. Ka edhe tipare të mira. Dhe gjithashtu, dashuria e madhe është pjesë e identitetit. Dhe identiteti im përbëhet nga shumë pjesë. Dhe jo për të gjitha këto pjesë do të doja të shkruaja, gjëra që s'janë letërsi.

**Kjo intervistë është vendi për ta bërë.**
Pikërisht. E di si është kjo paranojë. E di se çfarë do të thotë të shqetësohesh për atë që njerëzit po thonë dhe të fiksohesh me atë që po thonë për ty. Të gjitha këto gjëra Andreas i përjeton, ndërsa fama e tij është më e madhe se e çdo shkrimtari, por disa gjëra në lidhje me famën i kam mësuar nga përvoja ta tilla.

**A ka ndonjë shkrimtar që e keni zili?**
Nuk e ndiej këtë shumë, por tani jam dikushi. Në një univers të përfytyruar me shkrimtarë, çdo dy vjet, tre vjet, katër vjet, i gjithë vendi duhet të mbajë shënim se çfarë po shkruan dhe t'i kushtojë vëmendje për disa muaj librit të ri të shkrimtarit. Dhe duhet të shkruhen shkrime kritike kudo, duhet të ketë shtëpi plot me njerëz që duan të dëgjojnë për çfarë ka shkruar dhe libri i tij duhet të qëndrojë në krye të listës së librave më të shitur për vite me radhë dhe pastaj të gjithë duhet të bien në qetësi derisa të botohet libri tjetër. Kështu, pavarësisht se sa mirë po shkruan, nëse nuk boton një libër, kur sheh që dikush tjetër po tërheq vëmendjen, është një pjesë e vogël jotja që të thotë: "Pse po i kushtojnë vëmendje këtij njeriu? A e kanë lexuar të gjithë librin tim?" Është marrëzi. Marrëzi e vërtetë. Është ajo që shkrimtari në fshehtësi do. Mua s'më pëlqen ndjenja e vlerësimit të tepërt, megjithatë e kap veten duke menduar: "Epo unë nuk e mora këtë çmim. Kujt iu dha?" Nuk është zili, por në imagjinatën e shkrimtarit, kur fiton dikush, humbet dikush tjetër. Çdo gjë që merr dikush, të duket sikur po ta marrin ty. Është mirë të tregohesh racional për këtë dhe të thuash: "Është marrëzi ta mendosh kështu. Është hapësirë e madhe, ka vend për të gjithë ne." Por s'jam i sigurt. Mbase s'është ndjenjë universale. Mbase unë jam njeri i keq.

**Sidoqoftë, jam i sigurt që kjo ndjenjë mbizotëron edhe në profesione të tjera.**
Por shkrimtari në veçanti, e ndien më shumë. Shkrimtari e ndien sidomos për shkak se krijon nga hiçi. Ti si shkrimtar as që ke një vegël tënden, ke vetëm egon tënde të vogël që të bën të dukshëm dhe të pambrojtur, pa dikë që i bie trumbetës apo basit për të tërhequr vëmendjen e ti të fshihesh. Mund të zgjedhësh çdolloj fjale, sipas çdolloj rendi, nuk ka rregulla për këtë. Pra, ajo që ti nxjerr nga vetja s'ka emër kur del dhe thjesht ti je autori. Është shprehje e asaj që ti je. Dhe mendoj se egoja e shkrimtarit përballet në mënyrë unike me përmasat e realitetit.

**Si e gjeni ekuilibrin mes dëshirës për të mos dëgjuar kritika në median sociale dhe faktit se janë çështje që lidhen me internetin dhe demokracinë, çështje të rëndësishme, dhe ma merr mendja që doni të shpreheni për to. Për të kuptuar median sociale, a duhet të bëhesh pjesë e saj? Sepse besoj që ju s'e kaloni gjithë ditën në Twitter.**
Jo, s'e kaloj gjithë ditën në Twitter. Ndjenja që unë provoj

buron nga përvoja ime si shkrimtar, e cila më shtyn të mendoj se është më mirë të mos dish tepër për diçka. Bëhu pjesë e diçkaje, provoje, ndiq intuitën tënde, atë që po të tregon instinkti për atë që po vëzhgon. Pastaj shkëputu dhe mendo me të vërtetë për këtë dhe përdor imagjinatën. Kështu, komedia “Silicon Valley” na shpie tek instinkti primitiv që më tregon se kjo teknologji s’para duket se i ka çliruar njerëzit. Duket sikur njerëzit po sillen vërdallë të skllavëruar nga smartfonat. Kjo është ajo që shohim për sa i përket sjelljes. “Mendoj se është vërtet e rrezikshme, nëse jeni një amerikan i bardhë liberal, të mendosh që qëllimet e tua të mira mjaftojnë për të nisur të shkruash një vepër letrare për zezakët e Amerikës”. Kam ndjekur një kolegj të arteve liberale ku vlerësoheshe nëse flisje me kompetencë për gjërat që lexoje, për një kapitull libri që lexohej me nxitim një natë para provimit. Por si shkrimtar veprash letrare, nëse u kushton me të vërtetë shumë vëmendje gjërave të vogla, mund të marrësh shumë nga ato. Një përvojë e përjetuar fort mund t’i tregojë shumë një shkrimtari.




**A ka ndonjë kundërthënie mes kësaj dhe asaj që thatë më lart për ndjenjën e pamundësisë për të shkruar për racën për shkak të mungesës së përvojës?**
Jo, po flisnim për dashurinë. Për dashurinë. Pra, thashë se është vërtet e rrezikshme, nëse je amerikan i bardhë liberal mendon se qëllimet e mira për të shkruar një vepër letrare për zezakët e Amerikës mjaftojnë. Këtë dua ta theksoj fort. Kam menduar shumë për këtë, sepse çështja e racës është shumë e rëndësishme në Amerikë.

**A keni menduar të shkruani një libër më të shkurtër ose tregime. Librat tuaj të fundit kanë qenë voluminozë.**
Të gjitha romanet e mia kanë qenë të së njëjtës madhësi, rreth 530, 540 faqe. Kjo është madhësia e librave të mi. Vë re që më nxisin të shkruaj një roman të shkurtër që të mund të studiohet në shkollat e mesme, sepse kështu agjencia letrare fiton më shumë para të cilat mund të dhurohen për ruajtjen e zogjve.

**Si do t’i përkufizonit librat që shkruani?**
Epo, ato s’janë romane politike. Kjo është e sigurt.

**S’mendoni se librat tuaj janë politikë? Nuk janë si romani “Këshillë dhe kënaqësi” i Allen Drury-t, një roman për politikën e Uashingtonit, por ato janë politikë apo jo?**
Janë të vetëdijshëm për politikën, por nuk mbështesin ndonjë çështje politike. Dhe nuk kërkojnë të kesh pikëpamjet e shkrimtarit që t’i pëlqesh librat.

**Cila është rutina e të shkruarit kur jeni duke shkruar një libër?**
Shumë rrallë më ndodh të kem një rutinë të shkruari. Do të kisha shumë dëshirë të shkruaja gjatë gjithë kohës, por këto ditë janë në mënyrë tragjike kaq të pakta. Rutina që ndiqja kur shkruaja artikullin e botuar së fundi, një shkrim për Antarktidën i botuar në *New Yorker*: zgjohesha në tetë të mëngjesit dhe haja mëngjes, lexoja *New York Times* të cilën e lexoj akoma. Pastaj udhëtoja me makinë për dhjetë minuta për të shkuar te zyra ime. Është një dhomë e vogël, e errët, e ftohtë, e qetë dhe punoj në mënyrë ideale për gjashtë orë, gjatë të cilave përpiqem të shkruaj një mijë fjalë. Pastaj kthehem në shtëpi dhe dy orë i kaloj duke u marrë me e-mailin. Më pas shkoj në palestër, ose luaj tenis, pi diçka. Kathy vjen në shtëpi pasi i ka bërë një vizitë së ëmës. Hamë darkë, shohim televizion, lexojmë diçka. Këto ishin ditë të lumtura.

**Sa angazhoheni me kulturën popullore? A s’ndieni se duhet ta bëni, përderisa shkruani libra të rëndësishëm për Amerikën?**
Jo, jam dembel. S’më pëlqen të bëj kërkime për librat. Nganjëherë e detyroj veten me forcë të bëj kërkime kur s’di asgjë për temën, por ideja e ekspozimit ndaj gjërave vetëm për të grumbulluar përshtypje më duket se s’është punë për një romancier të vërtetë, sepse unë s’jam nga ata që dalin në rrugë me libër shënimesh në dorë. S’dua të ndodhem në situata të vështira, ndërsa përpiqem të gjej material që mund ta përdor për shkrimet. Jo, kultura popullore që konsumoj është vetëm ajo që më pëlqen. Kështu di shumë gjëra për Ligën Kombëtare të Futbollit (LKF), sepse, më duhet ta pranoj me keqardhje, vazhdoj ta pëlqej shumë të parit e ndeshjeve të futbollit të LKF.

***Përktheu: Granit Zela***

Në një univers të përfytyruar me shkrimtarë, çdo dy vjet, tre vjet, katër vjet, i gjithë vendi duhet të mbajë shënim se çfarë po shkruan dhe t’i kushtojë vëmendje për disa muaj librit të ri të shkrimtarit. Dhe duhet të shkruhen shkrime kritike kudo, duhet të ketë shtëpi plot me njerëz që duan të dëgjojnë për çfarë ka shkruar dhe libri i tij duhet të qëndrojë në krye të listës së librave më të shitur për vite me radhë dhe pastaj të gjithë duhet të bien në qetësi derisa të botohet libri tjetër



Shumë rrallë më ndodh të kem një rutinë të shkruari. Do të kisha shumë dëshirë të shkruaja gjatë gjithë kohës, por këto ditë janë në mënyrë tragjike kaq të pakta. Rutina që ndiqja kur shkruaja artikullin e botuar së fundi, një shkrim për Antarktidën i botuar në *New Yorker*: zgjohesha në tetë të mëngjesit dhe haja mëngjes, lexoja *New York Times* të cilën e lexoj akoma

E rrallë

## Patoku u bie daulleve




Pronari i një patoku në qytetin Sent Paul, Minesota, është një baterist me profesion dhe, me sa duket, manari i tij ka marrë diçka nga talenti i tij. Burri vuri re se patoku godet me këmbë në mënyrë ritmike kur e ngrit, kështu që iu kujtua ta vendoste mbi një daulle.

FOTO E DITES



Priftërinjtë e krishterë ortodoksë etiopë qëndrojnë pranë një pishine gjatë festimit të Timkat, Epifanisë Etiopiane, në qytetin Gondar. /AFP/

E rrallë

## Australia ka thyer rekord për dordolecin më të lartë deri më tani




Ndryshimet klimatike janë duke i sfiduar të gjitha shtetet, po ashtu edhe shtigjet australiane të skijimit. Megjithatë, dy persona në Australi nuk i kanë ndaluar përpjekjet që të thyejnë rekord, për dordolecin më të lartë ndonjëherë. Libri i rekordeve të Ginisit e ka njohur dordolecin Riesi, që nënkupton gjigant, si më të gjatin deri më tani, që ka 38.04 metra. Deri më tani rekordin e mbante Olimpia e gjatë 37.21 metra, një dordolec grua e ndërtuar në Maine të Shteteve të Bashkuara gjatë vitit të kaluar.

## BARSOLETA E DITËS



**Qytetari dhe polici:**
**Qytetari: Do të t'i them disa barsoleta me policë.**
**Polici: Ama kujdes, se unë jam polic.**
**Qytetari: S'ka gjë, se t'i them ngadalë-ngadalë.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno







Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams







Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nëse nuk keni arritur në asnjë mënyrë ta tërhiqni vëmendjen e personit që pëlqeni, thjesht duhet të provoni strategjinë e indiferencës.



**DEMI**
Lejojini vetes hapësirë për një arratisje dashurie. Në mbrëmje organizoni një darkë romantike, duke siguruar që askush të mos ju shqetësojë.



**BINJAKËT**
Edhe nëse jo gjithçka do të shkojë ashtu siç dëshironi, mos e humbni durimin. Në vend që të rrini në vend, kërkoni një kompromis të shëndetshëm.



**GAFORRJA**
Do të kaloni një ditë të këndshme dhe do të keni një kohë të shkëlqyeshme nëse pranoni pa hezitim një propozimin mjaft të pazakontë nga një miku juaj.



**LUANI**
Hëna njofton një ditë të ndërlikuar deri në drekë. Jini të vëmendshëm kur të përballeni me pengesa.



**VIRGJËRESHA**
Do të jeni të sigurt që çdo projekt i juaji mund të kryhet brenda një kohe shumë të shkurtër. Shkoni përpara, por mos harroni pengesat dhe vështirësitë siç bëni shpesh kur entuziazmi rritet.



**PESHORJA**
Ju jeni në rregull me ndërgjegjen tuaj, jeni i zënë në të gjitha kontekstet. Nuk është faji juaj, nëse ka njerëz që janë mësuar të dorëzojnë gjithë përgjegjësinë ndaj jush.



**AKREPI**
Nëse keni një bisedë në pritje me një bashkëpunëtor ose dikë që mendoni se është i rëndësishme për jetën tuaj private, sot është dita e duhur për ta përfunduar këtë bisedë.



**SHIGJETARI**
Kritikat nuk janë fjalët kyçe për të zgjidhur një krizë sentimentale, e cila nën peshën e Venusit disonant, bëhet pak më e ndërlikuar.



**BRICJAPI**
Falë Merkurit dhe Saturnit ju jeni i kthjellët, dinamik dhe i vendosur mendërisht, ndërsa Hëna lehtëson marrëdhëniet ndërnjerëzore.



**UJORI**
Nëse jeta private rrezikon të vuajë nën peshën e rutinës, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për punën.



**PESHQIT**
Do të jetë një ditë produktive. Ata që janë të pajisur me një frymë iniciative, shpikjeje dhe guximi do ta gjejnë veten të ballafaquar me raste të rëndësishme, të cilat janë shumë të lehta për t'u identifikuar dhe shfrytëzuar.

# Ledri Vula sjell projektin e ri



Këngëtari Ledri Vula ka publikuar projektin e parë muzikor për vitin 2020. Projekti i ri mban emrin "Piano Rap". Melodia e kësaj kënge është realizuar nga Butrint Buçinca dhe Duja, kurse për tekstin është kujdesur Ledri. Ndërkohë klipi është bërë në studion e "Red Box Entertainment".

# Mësohet se cila do të jetë puna e parë e Meghan Markle pas largimit nga Britania



Puna e parë e Meghan Markle pas largimit nga familja mbretërore me bashkëshortin e saj Harry do të jetë një shou kanadez, ku ajo do të paraqitet vazhdimisht. Sipas një burimi të afërt me ekipin e prodhimit, 38-vjeçarja Markle do të jetë e ftuar të shfaqet në mënyrë të përsëritur në 'I Do', 'Redo', ku do të bashkohet me shoqen e saj të ngushtë, stilisten e dasmave Jessica Mulroney, ylli i shfaqjes së ardhshme të realitetit në Netflix. Paraqitjet e saj në shfaqje do të jenë të rastësishme, sipas një burimi i cili nuk ka zbuluar nëse dhe sa do të paguhet Markle.




# Rita Ora e bën tatuazh fjalën "zog"

Këngëtarja e njohur Rita Ora ka bërë një tatuazh të ri në qafën e saj. Tatuazhi përmban fjalën "zog" të shkruar në gjuhën shqipe. Ora, me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram", tregoi arsyen e këtij tatuazhi. "Kur isha e vogël nëna ime Vera më thërriste zog, 'zogu i mamit'. Prandaj faleminderit Dr. Woo për krijimin e këtij kujtimi për mua të cilin e dua kaq shumë. Dhe për detajet shtesë në gishta", ka deklaruar këngëtarja duke zbuluar në këtë formë tatuazhet e reja në trup.

# "Rekord" divorci, Pamela Anderson ndahet 12 ditë pas dasmës



Vetëm 12 ditë pasi lidhi kurorë me Jon Peters, Pamela Anderson i ka dhënë fund martesës me producentin 74-vjeçar. Aktorja e "Baywatch" i tha "po" mogulit të filmave në një ceremoni sekrete në Malibu. Pamela, 52-vjeçare, u shpreh për "Hollywood Reporter" se ajo dhe bashkëshorti po ndahen për pak kohë për të rishikuar se çfarë duan në jetë, e se çfarë kërkojnë nga njëri-tjetri. "Dashuria është një proces dhe e kemi vendosur besimin tonë në proces", ka shtuar Anderson. Të dy, edhe Pamela dhe Jon, në të kaluarën kanë pasur katër martesa.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Elshani: Gjilani kundërshtar i fortë, por kemi ambicie për Kupë

Mesfushori Qemail Elshani për "Epokën e re" ka thënë se Drenica ka ambicie të mëdha në garën e Kupës ani pse në çerekfinale përballet me një skuadër të fortë siç është Gjilani. "Gjilani ka njërën ndër skuadrat më të forta në ligën tonë. Ekziston një superorganizim nga ana ai. Do ta japim maksimumin që të ecim tutje në Kupë sepse, siç thashë, kemi disa ambicie e një prej tyre është Kupa e Kosovës", ka thënë Elshani



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 SHKURT - Skuadra e Drenicës është duke i vazhduar stërvitjet me ritëm të lartë për sezonin pranveror. Kuqezinjtë një pjesë të përgatitjeve i kanë zhvilluar në Durrës, kurse nuk ka munguar edhe zhvillimi i ndeshjeve miqësore. Qemail Elshani të hënën për "Epokën e re" ka thënë se përgatitjet po shkojnë mirë dhe se Drenica do të vazhdojë të dhurojë futboll të bukur edhe në sezonin pranveror. "Përgatitjet kanë shkuar mirë. Kemi zhvilluar stërvitje fizike kondicionale të kombinuara me lojëra me top. Gjithashtu, kemi zhvilluar edhe disa ndeshje miqësore me motiv ta kapim filozofinë dhe konceptin e lojës. Besoj se Drenica do të vazhdojë të dhurojë futboll të bukur ashtu siç kemi dhuruar edhe më herët, sigurisht duke i shtuar vetes disa ambicie më shumë, por që arritja e tyre nuk është e domosdoshme", ka thënë Elshani.

Lidhur me synimet në sezonin pranveror, Elshani ka kërkuar kujdes të madh për faktin se diferenca në cilësi në mes të skuadrave është e vogël dhe se me dy humbje një skuadër mund të fundoset dhe me dy fitore të tjera mund të ngrehet. "Forca ndërmjet skuadrave nuk është edhe shumë e madhe. Duhet kujdes maksimal sepse, siç mund të ngrehësh në tabelë me dy fitore radhazi, ashtu edhe mund të biesh me dy humbje", ka deklaruar ai.

